

RELACION ARGUMENTIMI

Objekti: RIKONSTRUKSION I SHESHIT : "I.QEMALI" DHE RRUGA "VETERANI" POGRADEC

I. TE DHENA TE PERGJITSHME

Objekti i ketij rikonstruksioni te Sheshit "I.QEMALI" dhe rruga "VETERANI" ndodhet në Lagjen nr. 1 te qytetit dhe kufizohet me :

Në veri ---- Rr"Gani Butka"

Në jug ----- ; Rruga: "Industriale"e "Shemshi Koroveshi"

Në perendim-----Pallati 6 k parafabrikat

Ne Lindje ----- pallatet 5-6 kate pingul anes rr."Gani Butka"

II. GJENDJA EKZISTUESE

Ky shesh ndodhet ne nje zone te rendesishme te qytetit ne Lagjen nr. 1.
Perbehet nga ndertime te karakterit banim dhe sherbim kryesisht banesa kolektive 5-6 kate dhe individuale 2-3 kate.

Kufizohet me akset kryesore te qytetit sic eshte rruga "Gani Butka", Rr."Industriale" dhe me rugen "Veterani".

Sheshi eshte i pa trajtuar , i pa sistemuar si lidhje edhe për levizjen e banoreve drejt qendres dhe pjeseve te tjera ne qytetit.

- Te dhena për infrastrukturen.

Rjeti rrugor ekzistues shtrihet gjate gjithë sipërfaqes se kesaj zone duke e ndare ate ne - sheshin 'I.Qemali' e Rr.'Veterani" me:

- Rruge e sipërfaqe te pasistemuara, te pa trajtuara ne aspektin teknik.
- teresisht te demtuara me gropezime te theksuara në gjithë sipërfaqet dhe ndikojne negativisht si ne aspektin teknik dhe ate mjedisor
- Mungon krejtesisht rrjeti i kanalizimeve te ujrave sipërfaqesore, rrjedhja e pakontrolluar e te cilave ne rastet e reshjeve ndikojne ne ndotjen e qytetit.
- Ndricimi i rjetit rrugor eshte i amortizuar.

III. PROJEKTI I RIKONSTRUKSIONIT SYNON:

Per shkak te situates ekzistuese te pershkruar me siper si edhe per problemet e lehtesimit te levizjes se njerezve e mjeteve, lind e domosdoshme nderhyrja me fonde publike per zbatimin e projekteve te rikonstruksionit ne kete zone e cila eshte e perfshire ne objektivat e programit te parashikuar ne prioritetet e qeverisjes vendore per te beret e mundur:

Krijimin e kushteve e parametrave per nje permiresim te kesaj zone ne drejtim te:

- Permiresimit te cilesise se jeteses
- Permiresimit te ambjentit
- Permiresimit te qarkullimit te mjeteve te transportit dhe parkimet
- Lehtesimin e levizjes se njerezve .

IV. TE DHENA SPECIFIKE

- Siperfaqe e sheshit "I.Qemali"e Rr. "Veterani eshte : 2292m²

Ne sheshin 'I.Qemali'&RR.Veterani"ka respektivisht:

- Siperfaqe e pergjithshme rruge, shesh, trotuar : 2292 m²
- Siperfaqe e trajtuar me shtresa pllaka granili me boje : 258 m²
- Siperfaqe kunete me pllake 219m²
- kanalizimi i ujrave te bardha L = 247m²

Per realizimin e projektit me zerat të mesiperm nevojitet nje fond prej

13348288.45 leke

Investimi i kerkuar pervecse do të beje të mundur realizimin e objektit me gjithë elementet e tij , dote beje të mundur sistemimin ne nje zone te rendesishme me parametra bashkekohore dhe permiresim të kushteve të jeteses dhe të ambjentit ne teresi duke rritur cilesine e jeteses dhe permiresimin e qarkullimit te mjeteve te transportit , parkimet e duke lehtesuar levizjen e njerezve.

Hartoi

Ark.Veselina GUSHO

Ing.Majlinda KUQO